



## Periodiku AMF

**Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare nënshkruan Marrëveshjen e Mirëkuptimit në fushën e mbikëqyrjes së sigurimeve me Ministrinë Austriake të Financave e Autoritetin e Tregjeve Financiare të Austrisë**

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në datën 22 korrik 2009, nënshkroi në ambientet e Hotel Rogner Europa Park, Marrëveshjen e Mirëkuptimit në fushën e mbikëqyrjes së sigurimeve me Ministrinë Austriake të Financave e Autoritetin e Tregjeve Financiare të Austrisë.

*Vijon në faqen 2*

## Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

### Vështrim mbi tregun e sigurimeve janar-qershor 2009

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për periudhën janar-qershor, arritën shifrën 4,062 milionë lekë, përkundrejt 3,210 milionë lekë të realizuara në të njëjtën periudhë të vitit 2008 ose 26.52% më shumë.

*Vijon në faqen 3*

### Zhvillimet e tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për periudhën janar-qershor 2009

Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë, gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2009, u dominua në masën 96.32% nga transaksionet në instrumenta afatshkurtër (bono thesari) dhe 3.68% nga instrumenta afatgjatë (obligacione).

*Vijon në faqen 5*

### Zhvillimet e tregut të pensioneve private vullnetare për periudhën janar-qershor 2009

Tregu i pensioneve vullnetare mbetet ende një treg i vogël, parë ky si nga këndvështrimi i kontributeve dhe nga numri i kontribuesve. Në këtë treg, për periudhën janar-qershor 2009,

shihet një rritje prej 38.75% e kontributeve dhe një rritje prej afër 20.35% e numrit të kontribuesve, krahasuar me janar-qershor 2008.

*Vijon në faqen 7*

## Ngjarje dhe zhvillime të tjera

### Zhvillohet mbledhja e Komitetit Teknik të IOPS

Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Pensioneve (IOPS) në bashkëpunim me Organizatën për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), zhvilluan në datat 6-8 korrik 2009, pranë zyrave qendrore të OECD, Paris, Francë takimet e mëposhtme:

- o Mbledhjen e përbashkët të Grupit të Punës mbi Pensionet Private.
- o Seminarin mbi Menaxhimin e Riskut.
- o Mbledhjen e Komitetit Teknik të IOPS.

*Vijon në faqen 8*

*...Vijon nga numri i kaluar*

## Edukimi i konsumatorit

### Material për diskutim mbajtur nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit mbi sigurimet, perspektivë e forumit të CFO

( Pjesë e shkëputur nga: The Geneva Papers on Risk and Insurance Issues and practice, Vëllimi 33, nr.1, janar 2009)

### Çfarë duhet të kërkojmë? Hapat e tjerë

Përveç çështjeve kryesore të trajtuara më sipër (flukset e ardhshme të parasë, vlera e daljes, marzhet, njohja e fitimit), ekzistojnë dhe tema të tjera të rëndësishme, të cilat industria duhet t'i përpunojë më tej.

*Vijon në faqen 9*

## Në këtë numër:

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare nënshkruan Marrëveshjen e Mirëkuptimit në fushën e mbikëqyrjes së sigurimeve me Ministrinë Austriake të Financave e Autoritetin e Tregjeve Financiare të Austrisë

2

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

3

Ngjarje dhe zhvillime të tjera

8

Edukimi i konsumatorit

9



## Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare nënshkruan Marrëveshjen e Mirëkuptimit në fushën e mbikëqyrjes së sigurimeve me Ministrinë Austriake të Financave e Autoritetin e Tregjeve Financiare të Austrisë

me takime të ndërsjella, shkëmbim përvoja dhe asistencë teknike në realizimin e projekteve të rëndësishme të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Në fjalën e saj, Zj. Elisabeta Gjoni, Kryetare e AMF-së, vlerësoi bashkëpunimin e deritanishëm



*Znj. E Gjoni dhe Z. P. Braumüller, gjatë ceremonisë së nënshkrimit të marrëveshjes*

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në datën 22 korrik 2009, nënshkroi në ambientet e Hotel Rogner Europa Park, Marrëveshjen e Mirëkuptimit në fushën e mbikëqyrjes së sigurimeve me Ministrinë Austriake të Financave e Autoritetin e Tregjeve Financiare të Austrisë.

Nënshkrimi i marrëveshjes së mirëkuptimit është shprehje e bashkëpunimit institucional në mbikëqyrjen e përbashkët dhe shkëmbimin e informacionit midis rregullatorëve financiarë të të dy vendeve. Ky bashkëpunim ka nisur menjëherë pas investimeve të grupeve Austriake të sigurimeve Vienna Insurance Group dhe Uniqa Group Austria në Shqipëri dhe është konkretizuar

dhe rëndësinë e nënshkrimit të marrëveshjes në lehtësimin dhe efektivitetin e mbikëqyrjes së sigurimeve në të dy vendet.

Z. Peter Braumüller, përfaqësues i lartë i Autoritetit të Tregjeve Financiare të Austrisë, njëkohësisht edhe Kryetar i Komitetit Ekzekutiv të Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve, mbajti një prezantim mbi rëndësinë e vlerësimit të riskut në tregjet e liberalizuara të sigurimeve.

Në ceremoni ishin të pranishëm përfaqësues nga autoritetet rregullatore të të dy vendeve, të Ambasadës së Austrisë në Tiranë, të tregut të sigurimeve, të Shoqatës së Siguruesve, etj.

## Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

### Vështrim mbi tregun e sigurimeve janar-qershor 2009


Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për periudhën janar-qershor, arritën shifrën 4,062 milionë lekë, përkundrejt 3,210 milionë lekë të realizuara në të njëjtën periudhë të vitit 2008 ose 26.52% më shumë.

Vazhdon të ruhet tendenca e ndryshimit të strukturës së tregut në favor të sigurimeve vullnetare, ku primet e shkruara bruto zunë

47.89% të tregut, përkundrejt 52.11%, që zunë primet e sigurimit të detyrueshëm. Përsa i takon rritjes së tregjeve në veçanti, kemi një rritje në masën 31.28% të sigurimeve të Jetës dhe 26.11% të sigurimeve të Jo-Jetës.

Megjithë rritjen që shënuan sigurimet e Jetës, sërish 91.64% e primeve u gjenerua nga sigurimet e Jo-Jetës. Gjatë 6-mujorit të parë të 2009 u nënshkruan rreth 362,450 kontrata sigurimi, me një rritje prej 29.05% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2008.


### Struktura e tregut të sigurimeve, janar - qeshor 2009



Tabelë: Volumi i primit të shkruar bruto, janar - qeshor (2008 - 2009)

Lloji i sigurimit	Vlera (në mijë Lekë)	
<b>Periudha janar-qeshor</b>	2008	2009
A) Sigurimi i Jetës	258,745	339,683
B) Sigurimi i Jo - Jetës	2,951,357	3,721,857
<b>Nga këto</b>		
a) Sigurimi i Detyrueshëm	1,914,481	2,116,279
b) Sigurimi Vullnetar	1,036,877	1,605,578
<b>TOTAL</b>	3,210,103	4,061,540

Volumi i primit të shkruar bruto,  
janar - qershor 2009 (Jeta dhe Jo-Jeta)



### **Sigurimet e detyrueshme**

Gjatë periudhës janar-qershor 2009, sigurimet e detyrueshme motorike vazhduan të dominojnë strukturën e tregut, duke sjellë 52.11% të të ardhurave nga primet e shkruara bruto të tregut të sigurimeve.

Primet e shkruara bruto të sigurimit TPL e brendshme, në 6-mujorin e parë 2009, arritën 1,417,319 mijë lekë, ose 3.96% më shumë se në periudhën janar-qershor 2008.

Në janar-qershor 2009, primet e shkruara bruto të kartonit jeshil ishin 596,756 mijë lekë, ose rreth 27.37% më shumë se në periudhën janar-qershor 2008.

Primet e kontratës së sigurimit kufitar gjatë 6-mujorit të parë të 2009 arritën në 102,204 mijë lekë, apo 23.74% më shumë se në periudhën janar-qershor 2008.

### **Sigurimet vullnetare**

Në periudhën janar-qershor 2009, të ardhurat nga sigurimet vullnetare arritën në 1,945,261 mijë lekë, ose 50.14% më shumë se të ardhurat e të njëjtës periudhë të një viti më parë. Rritja e

primeve në sigurimet vullnetare vazhdon të lidhet ngushtë me nivelin e kreditimit nga bankat dhe hyrjen e investitorëve të mëdhenj, kryesisht në infrastrukturë.

Në sigurimet vullnetare të Jo-Jetës, me të ardhura 1,605,578 mijë lekë, vendin e parë e zunë sigurimet nga zjarri dhe rreziqet natyrore me rreth 29.18%, të pasuara nga sigurimi i përgjegjësive me 24.42%, sigurimi kasko me 19.70%. Peshë më të ulët patën sigurimi i aksidenteve dhe shëndetit, sigurimet e garancisë, mallrave në transport.

Të ardhurat nga sigurimet e aksidenteve dhe shëndetit në janar-qershor 2009 arritën në 207,413 mijë lekë, ose 66.09% më shumë se në periudhën janar-qershor 2008. Peshën më të madhe e mbajtën sigurimet e shëndetit me rreth 74.51% të ardhurave të këtij grupi.


Primet në sigurimet e Jetës në 6-mujorin e parë të vitit 2009 arritën në rreth 339,683 mijë lekë, ose rreth 31.28% më të larta se në po të njëjtën periudhë të vitin 2008. Rritja në sigurimet e Jetës është e lidhur ngushtë me rritjen e nivelit të kredihënies dhe sigurimit të Jetës për efekt kredie.

### **Ndarja e tregut midis shoqërive të sigurimit**


Tregu shqiptar i sigurimeve të Jo-Jetës ndahet ndërmjet kompanive të sigurimit: Sigal, Sigma, Insig, Atlantik, Interalbani, Albsig, Intersig dhe Eurosig. Sigal udhëhoqi tregun me 28.20% të primeve.

Aktivitetin e Sigurimit të Jetës e ushtruan kompanitë Sigal-Life, Insig dhe Sicred. Sigal-Life udhëhoqi tregun me 54.79% të primeve.

Pjesëmarrja e shoqërive në tregun e sigurimit, janar-qeshor 2009 (Jo-Jeta)



Pjesëmarrja e shoqërive në tregun e sigurimit, janar-qeshor 2009 (Jeta)



### **Dëmet**

Totali i dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimeve në janar-qershor 2009 kapi vlerën 788,396 mijë lekë, ose 23.39% më shumë se në janar-qershor të vitit 2008. Për vetë strukturën e tregut të paraqitur më sipër, pjesa më e madhe e dëmeve të paguara u përket sigurimeve motorike me 699,476 mijë lekë, apo 88.72% të totalit. Në portofolin “Kartoni Jeshil” kemi një rritje të dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimit me 29.77% dhe rritje të numrit të dëmeve të paguara me 22.82%, krahasuar me periudhën janar-qershor të vitit 2008.

### **Risigurime**

Gjatë periudhës janar-qershor 2009, të ardhurat nga primet e veprimtarisë risiguruese kapën vlerën 11,403 mijë lekë, të cilat i përkasin

portofolave të sigurimit “Aksidente Personale” dhe “Kasko” e janë prime të shkruara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

### **Zhvillimet e tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për periudhën janar-qershor 2009**

Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë, gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2009, u dominua në masën 96.32% nga transaksionet në instrumenta afatshkurtër (bono thesari) dhe 3.68% nga instrumenta afatgjatë (obligacione).

Nisur nga pjesëmarrja (numër transaksioni) sipas llojit të investitorëve, individë apo persona juridikë, shihet se në peshë specifike më të lartë janë investitorët individualë me 98.25% të totalit të transaksioneve në këtë treg.

### Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë janar - qeshor, 2008 - 2009

Lloji i Transaksionit	Vlera nominale (në mln lekë)		Ndryshimi (në %)
	2008	2009	09/08-1
<b>Periudha janar-qeshor</b>	<b>2008</b>	<b>2009</b>	<b>09/08-1</b>
<i>Letra me vlerë të Qeverisë</i>			
<b>A) Blerje në tregun primar</b>	<b>4,212.02</b>	<b>4,417.77</b>	<b>4.88</b>
Individë	3,320.86	3,299.61	(0.64)
Persona juridikë	891.16	1,118.16	25.47
<b>B) Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar</b>	<b>4,899.79</b>	<b>5,144.25</b>	<b>4.99</b>
Individë	4,386.15	4,241.66	(3.29)
Persona juridikë	513.65	902.59	75.72
<b>C) Blerje nga individët para afatit të maturimit</b>	<b>272.08</b>	<b>661.94</b>	<b>143.29</b>
Individë	262.73	409.74	55.96
Persona juridikë	9.35	252.19	2,596.11
<b>D) Vendosje e bonos si kolateral</b>	<b>68.53</b>	<b>73.39</b>	<b>7.10</b>
Individë	56.80	58.65	3.25
Persona juridikë	11.73	14.75	25.72
<b>E) Shlyerje e vlerës nominale në maturim</b>	<b>2,944.48</b>	<b>4,830.26</b>	<b>64.04</b>
Individë	2,774.64	4,212.33	51.82
Persona juridikë	169.84	617.93	263.83


#### Dy grupet e transaksioneve B dhe C

Transaksioni i llojit **B “Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar”** gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2009, ka shënuar një rritje prej 244 milionë lekë ose në masën 4.99%, krahasuar me periudhën janar-qershor 2008, ndërsa ka pasur një rënie të numrit të transaksioneve në masën 9.73%.

Transaksioni i llojit **C “Blerje nga individët para afatit të maturimit”** gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2009, ka pësuar një rritje prej 390 milionë lekë ose 143.29%, krahasuar me periudhën janar-qershor 2008, ndjekur nga një rritje në masën 23.57% të numrit të transaksioneve.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2008, vihet re një rënie në vlerë absolute e totalit të transaksioneve të llojit B dhe C, me rreth 634 milion lekë.

#### Letra me vlerë të Qeverisë, janar-qershor 2009



## Zhvillimet e tregut të pensioneve private vullnetare për periudhën janar-qershor 2009

Tregu i pensioneve vullnetare mbetet ende një treg i vogël, parë ky si nga këndvështrimi i kontributeve dhe nga numri i kontribuesve. Në këtë treg, për periudhën janar-qershor 2009, shihet një rritje prej 38.75% e kontributeve dhe

një rritje prej afër 20.35% e numrit të kontribuesve, krahasuar me janar-qershor 2008.

Në tregun e pensioneve private vazhdojnë të zhvillojnë aktivitetin 3 shoqëri pensionesh: Raiffeisen PENSIONS, Capital dhe Sigma IPP.


### Tregu i Pensioneve Private Vullnetare janar - qershor 2008,2009 (kontribute)

Shoqëria	Kontribute (në lekë)		Ndryshimi (në %)	Pjesa ndaj Totalit (në %)	
	2008	2009		2008	2009
<b>Periudha janar-qeshor</b>			<b>'09/'08 -1</b>		
Raiffeisen PENSIONS	29,890,395	36,136,250	20.90	67.07	58.44
Capital	4,088,000	13,126,870	221.11	9.17	21.23
Sigma IPP	10,584,744	12,569,362	18.75	23.75	20.33
<b>Total</b>	<b>44,563,139</b>	<b>61,832,482</b>	<b>38.75</b>	<b>100.00</b>	<b>100.00</b>


### Tregu i Pensioneve Private Vullnetare janar - qershor 2008,2009 (kontribuesve)

Shoqëria	Numri kontribuesve		Ndryshimi (në %)	Pjesa ndaj Totalit (në %)	
	2008	2009		2008	2009
<b>Periudha janar-qeshor</b>			<b>'09/'08 -1</b>		
Raiffeisen PENSIONS	1,570	1,661	5.80	44.06	38.74
Capital	1,315	1,705	29.66	36.91	39.76
Sigma IPP	678	922	35.99	19.03	21.50
<b>Total</b>	<b>3,563</b>	<b>4,288</b>	<b>20.35</b>	<b>100.00</b>	<b>100.00</b>

#### Struktura e Tregut të Pensioneve Private (sipas kontributeve)



#### Struktura e Tregut të Pensioneve Private (sipas numrit të kontribuesve)



## Ngjarje dhe zhvillime të tjera

### Zhvillohet mbledhja e Komitetit Teknik të IOPS

Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Pensioneve (IOPS) në bashkëpunim me Organizatën për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), zhvilluan në datat 6-8 korrik 2009, pranë zyrave qendrore të OECD, Paris, Francë takimet e mëposhtme:

- Mbledhjen e përbashkët të Grupit të Punës mbi Pensionet Private.
- Seminarin mbi Menaxhimin e Riskut.
- Mbledhjen e Komitetit Teknik të IOPS.

AMF, si një nga 60 anëtarët e IOPS, u përfaqësua në këto takime nga Kryetarja Zj. Elisabeta Gjoni. I formuar që në 2004 nga Rrjeti Ndërkombëtar i Rregullatorëve të Pensioneve (INPRS), shërben si një forum i hapur ndërkombëtar për diskutimin e politikave e shkëmbimin e pikëpamjeve dhe si një trupë të vendosjes së standardeve, që promovon praktikat më të mira në mbikëqyrjen e pensioneve. Qëllimi kryesor është të përmirësojë cilësinë dhe efektivitetin e mbikëqyrjes së sistemit të pensioneve private në mbarë botën, si rrjedhojë të rrisë zhvillimin dhe eficientë e veprimeve të tyre, duke lejuar një përgatitje të një burimi të sigurt për të ardhurat e pensioneve në sa më shumë vende të botës që të jetë e mundur.

- Në Mbledhjen e përbashkët të Grupit të Punës së OECD&IOPS, të ngritur për koordinimin dhe mbështetjen e mbikëqyrjes së Pensioneve Private, u diskutua mbi kontributet e përcaktuara dhe përfitimin e pensionit, u përmend eksperiencia që nga viti 1990 nga sistemi i pensioneve në Japoni, si dhe u lexua e u

dhanë indikatorët në Sistemin e Pensioneve Private.

- Gjatë zhvillimit të seminarit mbi menaxhimin e riskut në fondet e pensioneve, u propozua një sistem i menaxhimit të riskut, se cilat fonde të pensioneve duhet të përdoren, të sigurojë udhëzime për mbikëqyrësit e fondeve të pensioneve se si të kontrollojnë faktin se sisteme të tilla janë, jo vetëm në vendin e duhur, por gjithashtu operojnë me efektivitet. U sugjerua, se për të pasur një menaxhim efektiv të riskut duhen pasur parasysh 4 elementë kyç:

- **Menaxhimi i mbikëqyrjes dhe njohurive**, që kërkon një vendosje të qartë të përgjegjësi nga bordi mbikëqyrjes dhe që përfshin sigurimin e një strategjie të menaxhimit të riskut e sistemeve.
- **Strategjia dhe vlerësimi i riskut**. Bordi i mbikëqyrjes të kuptojë natyrën e brendshme dhe të jashtme të riskut me të cilin përballemi, vendosjen e niveleve të pranueshme të riskut dhe të sigurohemi që ky risk matet dhe monitorohet.
- **Sistemet e kontrollit**, që duhet të veprojnë në çdo nivel, të jenë pjesë integrale e aktivitetit të përditshëm e zbatimi i politikave dhe strategjive duhet verifikuar.
- **Informacioni, raportimi dhe komunikimi** janë jetësore, që strukturat e menaxhimit të riskut të jenë efektive.

Në këtë proces mbikëqyrje janë të domosdoshëm tërë grupi i aktorëve si: auditi i brendshëm, vetëvlerësimi, auditi i jashtëm, inspektimi on site, modele dhe vlerësimet e mbikëqyrësve të kontrollit të riskut, etj.

- Në Mbledhjen e Komitetit Teknik të IOPS, tema kryesore ishte *rigjenerimi nga kriza financiare globale që përfshiu edhe sistemin*



e pensioneve duke theksuar këtu rolin e madh të mbikëqyrësve të këtij sistemi. U diskutua mbi udhëzuesit për përdorim të aftësive të ndërhyrjes, të sanksioneve dhe zbatueshmërisë.

Në mbledhje u ra dakord për krijimin e komiteteve rajonale të punës, të cilat nuk do të jenë pjesë e qeverisjes së IOPS. Ato do të jenë forume ku do të diskutohet për tema të interesit rajonal. Këto komitete do të bashkëpunojnë, do të mbledhin materialet dhe do të organizojnë konferenca ose seminare për ato çështje që duan zgjidhje dhe që prekin rajonin.

Në programin për Sistemin e Pensioneve të paraqitur nga Toronto Centre në mbledhje, mundësohej bashkëpunimi me IOPS për çështje se si TC mund të: asistojë në vlerësimin e nivelit të kërkesave për programe të drejtimit për mbikëqyrësit e pensioneve, të asistojë në identifikimin e rasteve të mundshme dhe personave që përfaqësojnë dhe i zhvillojnë ato programe, të sigurojë fonde për zhvillimin e programeve, të nxisë programe për anëtarët e IOPS, të asistojnë me personel që ndihmojnë bordin këshillues, etj.

AMF është në vazhdim të punës së saj për hartimin e të gjithë kuadrit ligjor të Sistemit të Pensioneve Private dhe temat e mbajtura ishin të vlefshme për vazhdimësinë e punës së Autoritetit. Në Mbledhjen e Komitetit Teknik të IOPS, Znj. Gjoni prezantoi dhe një vlerësim të projektligjit të ri për “Fondet e pensionit vullnetar” në këndvështrimin e “Metodologjisë për Rishikimin e Sistemeve Mbikëqyrëse duke përdorur Parimet e IOPS”, i cili përveç harmonizimit me direktivat e BE, është bazuar në një shkallë të gjerë në parimet e IOPS.

....Vijon nga numri i kaluar

## Edukimi i konsumatorit

### Material për diskutim mbajtur nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit mbi sigurimet,

#### perspektivë e forumit të CFO

(Pjesë e shkëputur nga: *The Geneva Papers on Risk and Insurance Issues and practice*, Vëllimi 33, nr. 1, janar 2009)

#### Çfarë duhet të kërkojmë? Hapat e tjerë

Përveç çështjeve kryesore të trajtuara më sipër (flukset e ardhshme të parasë, vlera e daljes, marzhet, njohja e fitimit), ekzistojnë dhe tema të tjera të rëndësishme, të cilat industria duhet t'i përpunojë më tej.

- Kontrata investimesh me ose pa veçoritë e pjesëmarrjes opsionale (eng. Discretionary participating features, “DPF”):
  - A duhet të bëjnë pjesë në objektin e IFRS-Sigurime, Faza II apo të IAIS 39?
  - Një zgjidhje e mundshme mund të jetë:
    - kontrata investimi me “DPF” brenda objektit të IFRS-ve të sigurimit dhe
    - kontrata pa DPF sipas IAS 39, si dhe në linjë me vlerën e tregut mbi përkufizimin në sigurime të “vlerës aktuale të daljes” (veçanërisht duke hequr depozitën bazë (dysHEME).
    - duke ruajtur ndërkohë opsionin për amortizimin e kostos në IAS 39.
  - Nevojë për vëmendje të veçantë mbi aktivitetet bankare të grupeve “bancassurance”.
- Njësia e llogarisë dhe efekti i diversifikimit ndërmjet linjave të biznesit.
  - Marzhi i riskut duhet të përcaktohet sipas nivelit të portofolit. Siguruesit konsiderojnë që bazat e portofolit duhet

të përputhen me mënyrën se si biznesi manaxhohet. EPs-ja propozon të përcaktojë portofolin si “një grup kontratash të menaxhuara bashkë kur vlerësohen risqet”. Kjo do të reflektojë modelin e biznesit të përdorur nga siguruesit dhe do të lejojë që të konsiderohet efekti i korelacioneve negative, p.sh ndërmjet kontratave të sigurimit me afat dhe kontratave të pensioneve. Sipas IASB, detyrimet duhen llogaritur pavarësisht siguruesit që ka portofolin, kështu që pa marrë në konsideratë diversifikimin ndërmjet portofoleve të ndryshme.

Siguruesit do të mbështesin diversifikimin ndërmjet portofoleve që do të njihen. Një pyetje e hapur është: A duhet që efekti i diversifikimit të jetë diçka specifike e firmës (në përputhje me EEV) apo të mbështetet në një “standartizim”, që është baza e “tregut”? (transferimi tek një “pjesëmarrës tregu i shumë – diversifikuar”, siç mund të konsiderohet në një transferim në rrethanat e tregut, pavarësisht nivelit të diversifikimit të transferuesit ose të të transferuarit)

#### *Rishikim i EPs*

Anasjelltas, DP-ja krijon një mundësi për të rikonsideruar disa propozime të EPs, për shembull:

- Roli i “amortizuesve” të marzhit të fitimit (për ndryshimet në supozimet jo financiare),
- Aktivitetet e patrupëzuara të klientit (shpenzimet e blerjes/çështjet gjeografike), dhe
- Ripërtëritja e biznesit të përgjithshëm të sigurimeve (për aftësinë paguese: kontratat e ardhshme fitimprurëse duhet të njihen edhe nëse nuk ka kufizime).

#### *Çështje paraqitjeje -Pasqyra e të ardhurave*

IASB nuk ka bërë ende propozime për paraqitjen e pasqyrës së të ardhurave. Ka ngritur vetëm disa çështje të limituara në rast se primet duhet të paraqiten si të ardhura nëpërmjet llogarisë fitim/humbje, apo direkt si depozita në pasqyrën e bilancit, cilat zëra duhet të paraqiten në faqen e parë të pasqyrës së të ardhurave dhe nëse pasqyra e të ardhurave duhet të përfshijë të gjitha ndryshimet në detyrimet e sigurimeve.

Siguruesit duhet të konsiderojnë mundësinë që të bëjnë propozime kur komentojnë mbi DP-në. Në çdo rast, propozimet duhet t’u përgjigjen nevojave të përdoruesve (analistëve financiarë dhe investitorëve), veçanërisht për informacion mbi flukset e lira të parasë dhe për dërgimin e informacionit për palët përfituese e sigurimin e analizave. Propozimet duhet të marrin në konsideratë kalimin nga supozime të mbyllura në supozime të hapura dhe paqëndrueshmërinë që mund të rezultojë.

Një model i vetëm i paraqitjes së pasqyrës së të ardhurave për sigurimin e jetës dhe jo-jetës do të jetë në përputhje me, dhe të reflektojë, modelin e vetëm të llogaritjes mbështetur nga siguruesit Evropianë dhe nga IASB.

Ky model i vetëm mund të paraqitet sipas metodës së modelit të marzhit, i cili është më mirë i përshtatur me modelin e mënyrës së llogaritjes aktuale të mundshme dhe do të mundësojë për shpjegime të palëve përfituese në ndryshim nga një metodë tradicionale. Informacioni tradicional mbi primet nuk do të reflektojë vlerën e primeve neto të mundshme (NPV), e cila është planifikuar në flukset e zbritura të ardhshme të parasë (blloku i parë dhe i dytë). Ndërkohë, NPV-ja është përfshirë në raportimet e EEV. Gjithashtu, paraqitja tradicionale nuk do të jepte informacionin e flukseve të parasë, i cili është i paraqitur në pasqyrën e flukseve të parasë, por shumë sigurues kundërshtojnë që paraqitja e pasqyrës së të ardhurave për P&C nuk është e

detajuar dhe prandaj nuk duhet të ndryshohet. Me paraqitjen sipas modelit të marzhit të pasqyrës së të ardhurave, primet dhe dëmet nuk do të paraqiten më në faqen kryesore të llogarisë fitim/humbje, por në pasqyrën e flukseve të parasë, në pasqyrën e segmentuar të të ardhurave/shpenzimeve dhe në pasqyra të veçanta shitesë siç janë pasqyra mbi ndryshueshmërinë e detyrimeve, e cila do të përfshijë informacion të nevojshëm për raportet financiare të siguruesve të përgjithshëm, siç janë raporti dëme/prime dhe raporti i kombinuar.

Paqëndrueshmëria në pasqyrat financiare është një çështje kritike. Çdo mospërputhje kontabilizimi duhet të eliminohet. Në veçanti, një mënyrë për të evituar ndryshimet fiktive është të kesh njohje simetrike të ndryshimeve në vlerë (vlerë tregu) të aktiveve dhe ndryshimeve në “vlerën aktuale të daljes” të detyrimeve; kjo deri në masën që IAIS 39 lejon hapësira për ndryshime në vlerën e kategorisë së “aktiveve të gatshme për t’u shitur” për t’u njohur nëpërmjet ndryshimeve të kapitalit në vlerën e detyrimeve të sigurimeve në sajë të supozimeve financiare, të cilat duhet të njihen nëpërmjet kapitalit dhe jo direkt nëpërmjet llogarisë fitim/humbje.

#### *Hapat e tjerë*

Pas diskutimeve për DP, prioriteti i industrisë për muajt e ardhshëm do të jetë vazhdimi i bisedimeve direkt me IASB ose ndërmjet Grupit të Punës për Sigurimet të IASB, i cili pritet të rimblidhet në mars ose prill 2008. Plus çështjeve teknike të trajtuara më sipër, industria dhe IASB duhet të themelojnë një proces për të testuar dhe më pas zbatuar propozimet, duke pasur parasysh ndryshimet thelbësore të propozuara me prezantimin për qëllime të kontabilizimit të një modeli të mundshëm mbi matjet e supozimeve aktuale. Testimi duhet të përfshijë punë sasiore siç është QIS<sup>11</sup> për Solvency II.

Industria duhet të vazhdojë komunikim të mëtejshëm me palët e tjera të interesit:

- Komisioni Evropian, CEIOPS dhe IAIS.
- Analistë, investitorë dhe agjencitë e klasifikimit.
- Firmat e auditimit.
- EFRAG dhe institucionet kombëtare Evropiane që merren me vendosjen e standardeve.
- FASB në atë shkallë që do të vendosë të përfshijë projektin e IASB në axhendën e tij.

Ndërkohë që, industria duhet të plotësojë krahasimin ndërmjet propozimeve për Kontabilitet/EEV/Aftësisë paguese, të cilat kanë:

- Të përbashkëta në metoda në një nivel të lartë;
- Por diferenca në nivelin e drejtimit: parimet e nivelit të lartë për kontabilitetin/EEV guidë e detajuar/Aftësia Paguese II specifikime të detajuara me masat për zbatimin e direktivës në Kuadrin e Aftësisë Paguese II (specifikimet e cf QIS 3 si një model i asaj se çfarë mund të jenë masat e zbatimit që të përcaktohen nga Komisioni).

Industria duhet të arrijë në një zgjidhje të përshtatshme mbi shfaqjen e marzheve të fitimit tek të ardhurat dhe shënimeve përkatëse për risqet dhe marzhet e fitimit për përdoruesit e informacionit financiar dhe për mbikëqyrësit. Siguruesit mbështesin një standard kontabiliteti të bazuar në parime. Kjo do të thotë, që asnjë kërkesë urdhëruese nuk mund të dalë nga IASB apo organe të tjerë. Anasjelltas, siguruesit do të këshillohen të mendojnë se si drejtimi mund të zhvillohet në mënyrë që të arrihen të bëhen krahasime dhe të arrihet përputhshmëria me industrinë globale të sigurimeve. Këto detyra duhet të përmbushen duke



monitoruar (dhe komentuar) njëkohësisht edhe mbi dy projektet e tjerë të IASB dhe të Sigurimit II dhe projektet e IAIS.

Si përfundim, industria mund të ketë gjithashtu nevojë të reflektojë mbi pasojat e mundshme fiskale të modelit të IFRS-Faza II në shkallë kombëtare.

### **Konkluzion**

Industria Evropiane mirëpriti DP e IASB si një hap të rëndësishëm për zëvendësimin e mangësive të përkohshme të standardit IFRS 4 të kontabilitetit. DP e IASB mbi sigurimet mund të ketë përfaqësuar një fillim të mirë drejt një kontabiliteti që reflekton dhe modelin e biznesit të sigurimeve. Gjithsesi, DP është e ndërtuar bazuar në koncepte teorike të kontabilitetit dhe në një shpjegim themelor, i cili nuk kap me saktësi realitetet ekonomike të sigurimeve.

Siguruesit Evropianë besojnë se propozimet e IASB do të çojë në një vlerësim jo- ekonomik të detyrimeve në sigurime, në kundërshtim me objektivat e tij dhe me përjashtimet e kërkuara të “vlerës së tregut” (vlera e tregut përfshin vlerën dhe projektet e aftësisë paguese (IAIS and Solvency Aftësia Paguese II).

Për më tepër, siguruesit janë të shqetësuar me faktin që industria po përdoret si një “kavie” nga IASB. Kjo reflektohet në kompleksitetin dhe në natyrën shumë teorike të disa prej propozimeve, të cilat gjithashtu po merren në konsideratë dhe në disa projekte të tjera (detyrime/kapital, njohja e të ardhurave, llogaritja e vlerës së tregut, etj.).

Nëse propozimet e DP do të shndërrohen në standardin e ardhshëm (Faza II), pa bërë modifikime thelbësore, industria e sigurimeve do të mbetet prapa e krahasuar me industrinë e tjera. Industria e sigurimeve mbetet e prirur për të dhënë kontributin e saj së bashku me IASB për zhvillimin e një raportimi financiar të plotë dhe të saktë për sigurimet, në linjë me propozimet

aktuale të sistemit të aftësisë paguese. Në këtë kontekst, gatishmëria e industrisë për të folur me një zë të vetëm është thelbësore.

### **Referenca:**

CFO - Chief Financial Officer (Drejtor i Financës)  
IFRS - International Financial Reporting Standards (Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar)  
FASB - Financial Accounting Standard Board (Bordi i Standardeve Financiare të Kontabilitetit)  
EP- Elaborated Principles (Parimet e detajuara)  
IAS 39 - Financial Instruments (SNK 39-Instrumentat Financiarë)  
EEV-European Embedded Value (Metodë vlerësimi konservative për shoqëritë e Jetës)  
IAIS - International Association of Insurance Supervisor (Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve)  
DPF - Discretionary participating features (e drejtë kontraktuale për të marrë përfitime shtesë, përveç përfitimeve të garantuara)  
NPV - Net premium value (Vlera e primit neto)  
QIS - Quantitative impact studies (Studime me ndikim sasior)  
CEIOPS - The Committee of European Insurance and Occupational Pensions Supervisors (Komiteti Evropian i Mbikëqyrësve të Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale)  
EFRAG - European Financial Reporting Advisory Group (Grupi Evropian Këshillues për Raportimin Financiar)

<sup>11</sup> QIS: studime me ndikim të matshëm

### ***Për këtë numër punuan:***

E. Shehi, R. Guri, R. Eltari, E. Zalta, Dh Hazbiu, E. Kokona